



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Nr. *Extra* Prot.

Tiranë, më 16.07.2020

Drejtuar: Znj. Milva **EKONOMI**
Kryetar
Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat

Lënda: Komente dhe sugjerime lidhur me projektligjin “Për amnistinë fiskale dhe penale për subjektet që bëjnë deklaram vullnetar të pasurive”

E nderuar Znj. Ekonomi,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë komentet dhe sugjerimet e sektorit bankar në lidhje me projektligjin “Për amnistinë fiskale dhe penale për subjektet që bëjnë deklaram vullnetar të pasurive”.

Duke Ju falënderuar dhe vlerësuar për bashkëpunimin, mbetemi me shpresë në marrjen në konsideratë të komenteve tona,

Me respekt,

Spiro Brumbulli

Sekretar i Përgjithshëm

Komente dhe sugjerime lidhur me projektligjin “Për amnistinë fiskale dhe penale për subjektet që bëjnë deklaram vullnetar të pasurive”

Në projektligj është parashikuar nxjerrja e akteve nënligjore, të cilat do të përcaktojnë në mënyrë më shteruese detyrat, përgjegjësitë, rolet dhe procedurat përkatëse, por, gjithsesi, shprehemi se është e nevojshme që në ligj të mirë përcaktohen:

- i. Pozicioni i bankave tregtare, duke konsideruar dhe ligjin Nr. 9917 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”. A do të prevalojë amnistia fiskale edhe mbi këtë ligj? Në ligj duhet të shprehet qartë dhe në mënyrë eksplicite që banka nuk ka barrën e provës për verifikimin e burimit të fondeve në kuadër të kërkesave për parandalimin e pastrimit të parave. Për këtë qellim, banka do të mjaftohet duke marrë nga klienti formularin e deklaramit të aprovuar dhe sigluar nga autoriteti përkatës (DPT).
- ii. Cilat do të jenë verifikimet që do të kryeje Njësia Speciale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve? Vetëm formale për mënyrën e plotësimit të formularit të deklaramit vullnetar?
- iii. A do të paraqesin deklaruesit ndonjë informacion shtesë për të vërtetuar, p.sh., për fondet e krijuara në emigracion? Kujtojmë këtu raste të njohura nga praktika, ku shtetas shqiptarë kanë përfitur rezidencë /nënshtetësi të vendit përkatës edhe duke ndryshuar identitetin e tyre: emër dhe ose mbiemër, datëlindje, vendlindje. Si do të ndiqen këto raste, pasi i njëjti deklarues mund të paraqesë të dy identitetet dhe të kërkojë 2 deklarime vullnetare, pa lidhur që kemi të bëjmë me të njëjtin individ.
- iv. A do të jenë bankat të detyruara t’i pranojnë këto fonde? Apo do të kenë të drejtën të vijojnë me vigjilencën e duhur /zgjeruar? Dhe në raste të caktuara për klientë me historik, bankat gëzojnë të drejtën të verifikojnë klientët me listat e tyre të brendshme /grupeve bankare të cilave ju përkasin.

Duke iu referuar qëllimit të projekt-ligjit, krijohet ideja se subjektet deklarues të shumave në të holla janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale lidhur me mënyrën e krijimit, mbajtjen apo posedimin e pasurive të deklaruara (duke nënkuptuar këtu nga momenti i fillimit të procesit të deklaramit); ndërkohë që, duke iu referuar nenit 16, rezulton se këtë të drejtë e kanë subjektet (përfitues), të cilat janë pajisur me vërtetimin e përfundimit të procesit të deklaramit vullnetar (pra, vetëm në momentin e lëshimit të vërtetimit përkatës nga Njësia Speciale - neni 8, pika 2 dhe neni 15).

Sipas këtij leximi të dispozitave të projekt-ligjit, bankat nuk janë të zhveshura nga detyrimet ligjore të ligjit nr. 9917, date 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, dhe, për rrjedhojë, do të jenë të detyruara të zbatojnë të gjitha detyrimet, pa asnjë ndryshim, për vigjilencën e duhur dhe /ose të zgjeruar për depozitimet e shumave në të holla në llogaritë bankare të çelura për qëllime të këtij projekt-ligji dhe në rast dyshimi për pastrim parash të kryejnë raportimin pranë Autoritetit Përgjegjës (Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave).

Nëse qëllimi i projekt-ligjit nuk ka qenë i tillë (gjë e cila mund të rezultojë edhe në interpretim të nenit 4, i cili parashikon rastet e kufizuara në të cilat nuk gjejnë zbatim dispozitat e këtij projekt ligji, apo dhe për sa parashikohet në nenin 7 ku parashikohet bashkëpunimi i Njesisë

Speciale me Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave), atëherë është e nevojshme që të kryhen ndërhyrjet e nevojshme legjislative për të qartësuar pozicionin e bankave.

Në të gjitha rastet, është i nevojshëm rishikimi i dispozitave ligjore për të eliminuar çdo paqartësi që mund të shkaktohet si rrjedhojë e sa është parashtruar më lart. Një alternativë mund të ishte depozitimi i shumave në të holla në llogari bankare në përfundim të vlerësimit nga Njësia Speciale pas deklarimit vullnetar ose në një fazë paraprake (përpara lëshimit të vërtetimit nga Njësia Speciale) për të mundësuar depozitimin e shumave në llogari bankare, duke përjashtuar bankat nga përgjegjësia e kryerjes së vigjilencës së duhur apo të zgjeruar, gjë e cila do të sillte jo vetëm fleksibilitet në kryerjen e procedurave, por edhe në bërjen efektive të mekanizmave nxitës të përmendur në nenin 2.

Gjithashtu, parë nga perspektiva e një banke pjesë e një grupi bankar që zbaton standardet EU dhe është subjekt auditimi për to, është shumë e rëndësishme që të vlerësohet ky pozicion dhe e drejta e bankave për të kërkuar informacion, evidenca (*veçanërisht në rast dyshimi*) dhe të mos bazohen vetëm në vetë-deklarim.

^{3/4} Neni 1

Objekt i këtij ligji janë pasuritë të cilat janë fituar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, apo dhe pasuritë që fitohen gjatë zbatimit të këtij ligji, por para përfundimit të fuqisë ligjore? (*Duhet të specifikohet qartësisht, pasi ligji është shprehur vetëm në paragrafin e parë të nenit 18 për amnistinë penale.*)

^{3/4} Neni 3, pika b

Për sa i përket termit “...ose instrumente të tjerë të tregjeve financiare”- në kuadër të Shkëmbimit Automatik të Informacionit (CRS), nëse këto fonde mbeten balancë në llogari, do të raportohen nëse klienti bie nën përkufizimin “person i raportueshëm”?

^{3/4} Neni 4

Nevojitet të saktësohet nëse do të konsiderohet ky projektligj përkundrejt detyrimit të bankave në lidhje me ligjin nr. 9917 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

Pika 3

Parashikimi i përparësisë së ligjeve nr. 20/2020 dhe nr. 90/2019 kundrejt këtij projektligji, tregon se, në rastin e deklarimit të një pasurie të paluajtshme, ligjërimi i pronësisë së saj në emër të vetë deklaruësit, nuk do jetë përfundimtar.

Duhet dispozita ligjore shumë specifike për këtë, për të saktësuar për sa kohë do jetë e pakonfirmuar kjo pronësi e vetë deklaruësit /si do funksionojë verifikimi paralel mes Njësive Speciale dhe Kadastrës, etj. Në të kundërt, do ndodhemi para pasigurisë juridike, të stimuluar nga një ligj i ri.

^{3/4} Neni 6

Ashtu siç edhe kemi komentuar në nene të tjera, nevojitet të përcaktohet qartë cila është pala përgjegjëse që do të kryejë verifikimet e duhura nëse ky nen është zbatuar.

Pika b

Mendojmë se duhet të jepet një kufi kohor se kur “kanë qenë mbajtës të detyrave apo funksioneve përkatëse” (p.sh., 30 vitet e fundit). Kush i bën verifikimet përkatëse gjatë momentit që depozitohen fondet në bankë, apo verifikimet bëhen para depozitimit (siç kemi propozuar)? Ligji aktual për PEP-at parashikon mbajtje të statusit deri në 3 vite pas lënies së mandatit. Mendojmë se nuk del qartë dhe duhet të riformulohet.

Çfarë ndodh me të afërm të tjerë të PEP-ave që nuk janë pjesë e trungut të familjes?

Çfarë ndodh nëse persona në përbërje të gjendjes familjare shkëputen nga trangu i familjes përpara hyrjes në fuqi të ligjit në mënyrë që të përfitojnë prej tij?

A do ketë kontrolle specifike për sa më lart ?

^{3/4} Neni 7

Pika 2

Në këtë pikë duhet të shprehen qartë detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e kësaj njësie (filtrimi i subjekteve nëse kualifikohen apo jo si subjekte të ligjit, due-diligenca për burimin e fondeve, përcaktimi i normës së aplikueshme të tatimit dhe vlera absolute e tij) dhe më pas të detajohen procedurat me akte nënligjore.

Mungon afati ligjor brenda të cilit Njësia Speciale do të përmbushë detyrat për mbledhjen e informacionit, përditësimin e të dhënave, etj. Këto punë përgatitore duhet të jenë gati në momentin kur ligji do hyjë në fuqi, në të kundërt mungesa e parapërgatitjes do sjellë pamundësinë e ushtrimit të të drejtës nga subjektet që duan të vetë deklarojnë.

Pika 3

Përveç sa kemi kërkuar që të parashikohet në projektligj, akti nënligjor të qartësojë detyrat dhe përgjegjësitë e secilës palë në kuadër të këtij bashkëpunimi.

Pika 4

Struktura, organizimi, funksionimi dhe rregulloret e veprimtarisë së Njesisë Speciale duhen miratuar me VKM, për shkak të rëndësisë së tyre.

^{3/4} Neni 8

Pika 3

Përcakton se procesi fillon me depozitimin e formularit dhe përfundon me pajisjen e subjektit me vërtetimin përkatës të lëshuar nga autoriteti. Por, nga dispozita të veçanta të këtij projektligji, vihet në dyshim ky përcaktim ose ka paqartësi.

Pika 4

Nuk del e qartë se kur depozitohen në bankë të hollat, para apo pas depozitimit të formularit të deklaramit vullnetar. Duhet përcaktuar se subjekti e derdh në llogari bankare shumë e vetë deklaruar vetëm pasi të jetë kryer vetë deklarimi të Njësia Speciale dhe të jetë pajisur me vërtetimin përkatës, kopjen origjinale të të cilit ai e depoziton në bankë bashkë me shumë e vetë deklaruar. Në të kundërt, bankat do ishin në paqartësi dhe pasiguri juridike, pasi ato nuk mund dhe nuk duhet të bëjnë due diligencën e subjektit vetë deklarues (pra, nëse ai hyn apo jo në rastet përjashtimore të projektligjit, etj.), por vetëm do të japin mundësinë të ushtrijë të drejtën si përfitues, subjekti që e ka përfitur këtë status nga autoriteti përkatës shtetëror.

Gjykojmë dhe propozojmë që **depozitimi i shumave në bankë duhet të shoqërohet me një vërtetim të lëshuar nga Njësia Speciale, e cila ka ezauruar edhe hapat e verifikimit (sa parashikohet në nenin 6 dhe 7 lidhur me due-diligencën e burimit të fondeve), si dhe ku të jetë përcaktuar norma e aplikueshme e tatimit përkatës si dhe shuma e tatimit në vlerë absolute (për sa kemi argumentuar në komentet për nenin 12).**

Sa më lart, propozojmë që në këtë pikë të shtohet sa është cituar /nënvizuar më sipër.

^{3/4} Neni 9

Pika a)

Duke qenë se subjekti mund të ketë një llogari ekzistuese në banka, mund të përdoret edhe kjo llogari ekzistuese për këtë qëllim apo nevojitet të hapet një llogari e veçantë për këtë qëllim? Llogaritë për individët do jenë në emër të këtij të fundit, po për subjektet juridike do jenë në emër të shoqërisë dhe do veprojnë me autorizim personi që do kryejë derdhjen në llogari?

Pika b)

Duhet të përcaktohet qartë se formulari i deklaramit vullnetar do të verifikohet nga Njësia Speciale pranë DPT dhe në të duhet të jetë specifikuar shuma e deklaruar për t'u depozituar, vlera e tatimit të posaçëm që duhet mbajtur nga kjo shumë, si edhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet derdhja e shumave në bankë.

A kanë bankat detyrim për të vërtetuar diçka në këtë formular, p.sh., plotësimin e ndonjë fushe specifike? Në rast se po, të parashikohet dhe të specifikohet në udhëzimin përkatës.

Pika c)

Banka, si dokument justifikues për kryerjen e këtij depozitimi, duhet të kërkojë vetëm formularin e deklaramit vullnetar me të cilin është pajisur klienti nga Njësia Speciale? Duhet të përcaktohet qartësisht roli i institucioneve financiare në këtë proces.

Mendojmë se Njësia Speciale duhet të lëshojë një vërtetim, me të cilin prezumohen të kryera prej tyre detyrimet e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji (verifikimi që subjekti nuk është i përjashtuar në kuptim të nenit 6 të këtij ligji, due-diligencia për burimin e fondeve apo dhe

përcaktimin e normës së aplikueshme të tatimit dhe vlerës absolute) dhe banka nuk do të kërkojë informacione apo dokumentacione lidhur me justifikimin e krijimit të fondit që do të depozitohet (siç kemi argumentuar edhe në nenin 8 më sipër).

Propozojmë që në fund të kësaj pikë të shtohet: “...*pasi është pajisur me Vërtetimin e lëshuar nga Njësia Speciale.*”

^{3/4} Neni 10

Parashikon se për pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të regjistrueshme, me përfundimin e procesit të deklarimit vullnetar, subjekti përfitues ka prioritet në kryerjen e regjistrimit të pasurisë. Kjo bie në kundërshtim me sa përcakton paragrafi 3 i Neni 4. Duhet rishikuar të dy përcaktimet që të jenë në të njëjtën linjë.

^{3/4} Neni 11, pika 4

Parashikohet se për shoqëritë tregtare shumtë e deklaruara e të amnistuara mund të përdoren lirisht, përfshi edhe atë për qëllime personale. A nuk do të ishte më mirë të regjistrohen në kapitalin e shoqërisë si zmadhim i tij me mjete likuide? Kjo do të ndihmonte pozitivisht kredithënien.

^{3/4} Neni 12

Sipas parashikimeve të këtij neni bankave u caktohet roli i agentit tatimor për përllogaritjen dhe mbajtjen e tatimit të posaçëm dhe më pas të transferimit të shumave në llogarinë e posaçme të thesarit të ministrisë përgjegjëse për financat. Për sa më sipër, bankat do të jenë të detyruara të zbatojnë të gjitha dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke qenë subjekte të mundshme të sanksioneve të parashikuara në këtë ligj gjithashtu.

Nëse bankat do të vepronin për pranimin e depozitimeve të shumave në të holla, pas lëshimit të vërtetimit, apo në një fazë paraprake përkundëjt një dokumenti zyrtar të lëshuar nga Njësia Speciale, sikundër kemi parashtruar më lart, atëherë jo vetëm procesi do të ishte me fleksibël, por edhe pozicioni i bankave do të ishte brenda perimetrit të veprimtarisë bankare, pa ndikim në marrëdhënien e subjektit deklarues dhe shtetit.

Për sa më lart, vlerësojmë dhe propozojmë se detyrimi për përcaktimin e **normës së aplikueshme të tatimit përkatës si dhe shumave të tatimit në vlerë absolute** të jetë përgjegjësi e Njesisë Speciale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e cila duhet ta pajisë subjektin me një vërtetim përkatës. Banka mund të qëndrojë njësia zbatuese, e cila mban tatimin sipas vlerës së përcaktuar nga njësia speciale.

^{3/4} Neni 13

Nëse klienti, të hollat e legalizuara bazuar në këtë ligj, në të ardhmen, i nxjerr jashtë vendit me transfertë bankare, në rast të investigimeve të bankave korrespondente mbi burimin e krijimit të këtyre fondeve, çfarë informacioni duhet të japin bankat?

Pika 2

Nëse personi nuk vjen në Shqipëri personalisht, në emër të kujt do të çelet llogaria në bankë?

Në cilin moment do të mbahet tatimi i posaçëm? Duhet të qartësohet në udhëzim ky rast dhe si do të veprohet në praktikë.

Në përgjithësi, është e paqartë dhe e paplotë mënyra se si do kryhet riatdhesimi i pasurive që ndodhen jashtë territorit të Shqipërisë. Nuk është e mjaftueshme vetëm të thuhet se formularin këto subjekte e paraqesin në autoritetet përgjegjëse doganore kufitare.

Njëkohësisht, ka nevojë që rregullat dhe procedurat e këtij procesi të caktohen me VKM dhe jo udhëzim të MF.

^{3/4} Neni 14, pika 1/b

Vdekja e subjektit deklarues individ nuk ka pse të bëhet shkak për ndërprerjen e procedurës së deklarimit vullnetar. Kjo e drejtë është e logjikshme t'ju kalojë trashëgimtarëve të subjektit.

^{3/4} Neni 15

Jemi të opinionit që pjesë e ligjit duhet të jetë dhe periudha pas sa kohësh duhet banka ta lejojë individin të përdorë këto shuma. (Kjo për faktin se në amnistinë e vitit 2011 ka qenë parashikuar një periudhë e caktuar në ligj për mospërdorimin e fondeve, që ishte e ndryshme për transfertat brenda vendit dhe e më gjatë për transfertat jashtë vendit.)

Nuk del qartë nëse fondet deri në marrjen e vërtetimit nuk mund të disponohen nga personi që i ka depozituar, përderisa parashikon se “konsiderohet subjekt përfitues i pasurisë”, pra, do të mbeten të “bllokuara” në bankë deri në paraqitjen e vërtetimit dhe nga kalimi i afatit 20 ditor. Konsiderojmë që duhet të riformulohet që të dalë qartë kuptimi që ka dashur t'i japë ligjvënësi.

Ky nen duhet riparë, pasi krijon shumë konfuzion në zbatim, veçanërisht për pasuritë në të holla. Duhet sanksionuar njëherë e mirë që bankat duhet të përfshihen në këtë proces vetëm pasi procesi i “vetting mbi pasuritë & të hollat” e subjektit, të kenë përfunduar nga Njësia Speciale dhe është lëshuar vërtetimi përkatës. Pikat 1 dhe veçanërisht pika 2 e këtij neni, e lidhin lëshimin e vërtetimit vetëm 20 ditë pas përfundimit të deklarimit, i cili përmban edhe depozitimin në të holla. Kjo nënkupton që procesi i verifikimit është detyrë e bankës nëse subjekti vetë deklarues është apo jo pjesë e rasteve përjashtimore, për të cilën ruajmë rezervat tona sa kemi argumentuar edhe më lart.

^{3/4} Neni 18

Bankat nuk duhet të konsiderojnë raportimin si kërkesë të ligjit për Raportimin e Aktiviteteve

të Dyshimta? Duhet sqaruar /saktësuar edhe një herë qëndrimi i këtij ligji përkundrejt ligjit 9917 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” si dhe përgjegjësia e Njësisë Speciale.

³/₄ **Neni 19**

Është e nevojshme që në këtë ligj të përcaktohet se ai zbatohet vetëm për të ardhurat dhe pasuritë e përftuara deri në datën e miratimit të tij, në mënyrë që të eliminohet çdo mundësi për abuzim pasi të bëhen publike dispozitat e ligjit.

³/₄ **Neni 20**

Duhet të përcaktohen afate shumë të sakta dhe të shkurtra për aktet nënligjore në zbatim të ligjit, të cilat duhet të jenë gati në momentin e fillimit të efekteve të zbatimit të ligjit.

³/₄ **Neni 21**

Efektet e zbatimit të ligjit për efekt të fillimit të vetë deklarimit duhet të jenë më shumë se 30 ditë nga hyrja në fuqi (nuk ka kohë për aktet nënligjore, strukturën e njësisë speciale, krijimin e infrastrukturës me data bazë që do vlejë për procesin e verifikimit, etj.).